



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE**

**Nr. i Dokumentit: 24.28.1-2016-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT  
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR  
TË AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURRENCËS  
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

**Prishtinë, qershor 2017**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm - Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Laureta Matoshi-Pozhegu - Udhëheqëse e ekipit dhe anëtares Adelina Selmani, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit - Bujar Sejdiu.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	18
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	19
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak .....	22
Shtojca IV: Letërkonfirmimi .....	24

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetore të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit<sup>1</sup>, të datës 19/05/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se burimi dhe shfrytëzimi i fondeve në pasqyrën e pranimeve dhe pagesave është mbivlerësuar për 2,500€, të hyrat e inkasuara në vlerë 3,000€ nuk janë prezantuar në raportin e ekzekutimit të buxhetit dhe pasuritë jo-kapitale janë nënvlerësuar për 13,083€.


Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin e Komisionit dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

<sup>1</sup> Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimit të Auditimit”

## Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



## Përgjigja e Kryetarit të Komisionit

Kryetari i Komisionit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

---

# 1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.1 Opinioni i auditimit

### Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

### Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

---

## Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Në pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, burimet dhe shfrytëzimi i fondeve janë mbivlerësuar për 2,500€;
- Në raportin e ekzekutimit të buxhetit nuk janë prezantuar të hyrat e pranuar në vlerë 3,000€ ndonëse janë shpalosur në shënimin 14; dhe
- Blerjet e pasurive jo-kapitale (furnizime për zyre dhe kompjuterë) në vlerë 13,083€ nuk janë regjistruar në regjistrat e pasurisë.

Këto gabime reflektojnë mungesën e një rishikimi kritik të PFV-ve dhe dobësi në menaxhimin e pasurive. Opinioni jonë nuk është modifikuar për këtë çështje.

## Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i AKK-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Kryetari i Komisionit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të AKK-së.

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të

auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

AKK kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK), etj.

Në kontekst të PVF-ve, nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur përveç çështjeve të paraqitura në nënkapitullin 1.1 të këtij raporti.

Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në MF, mund të konsiderohet e saktë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

## 1.3 Rekomandimi për pjesën e parë të raportit

Për çështjen e sipërpërmendura të opinionit i auditimit jepet rekomandimi:

**Rekomandimi 1** Kryetari i Komisionit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i parandaluar gabimet në PFV-të e vitit 2017 dhe për të siguruar një vlerësim të saktë të pasurive.



## 2 Qeverisja

### Hyrje

Aranzimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për AKK-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Dobësitë e identifikuar brenda AKK-së lidhen veçanërisht me cilësinë e raportimit menaxherial dhe menaxhimin e rrezikut. Pyetësi i vet-vlerësimit, i plotësuar nga AKK, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm nuk janë të vendosura.

## 2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2016 të AKK-së ka rezultuar më gjashtë (6) rekomandime kryesore. AKK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, katër (4) rekomandime janë në proces të zbatimit ndërsa dy (2) nuk janë zbatuar fare. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

### Rekomandimi

#### Çështja 2 – Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

- E gjetura** Asnjë rekomandim i vitit të kaluar nuk është zbatuar plotësisht sepse AKK nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. Kjo pasqyron mungesën e fokusit nga menaxhmenti për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim identifikohen dhe adresohen. Një qasje e tillë është e nevojshme për të menaxhuar përmirësim të vazhdueshëm në të gjithë organizatën.
- Rreziku** Mungesa e një monitorimi efektiv të zbatimit të rekomandimeve ka rezultuar në dobësi të vazhdueshme lidhur me aranzhimet e qeverisjes dhe menaxhimin e pasurive.
- Rekomandimi 2** Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet, duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor, si dhe stafin llogaridhënës për zbatimin e tyre. Në fokus fillestar duhet të jenë fushat e një rëndësie më të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.

## 2.2 Pyetësi i vetëvlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorit të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për AKK-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

### Çështja 3 – Pyetësi i vetëvlerësimit – Prioritet i lartë

**E gjetura** Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Ndonëse janë ndërmarrë hapa për menaxhimin e rrezikut ky proces ende nuk është në nivelin që kërkohet me procedurat e MFK-së. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se përgjegjësia për zhvillimin e menaxhimit të rrezikut nuk është alokuar në mënyrë të qartë brenda organizatës;
2. Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe sigurimin e strategjisë me kosto të plotë) ende nuk janë të vendosura nga AKK. Çështjet e monitorimit janë shqyrtuar më hollësisht në nënkapitullin 2.4; dhe
3. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit konsiderohen të vendosura mirëpo raportet nuk janë përpiluar gjithmonë në baza të rregullta kohore dhe nuk janë të cilësisë së kërkuar.

Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë së pyetësorit nga ana e AKK-së dhe rëndësinë se tij për t'i mbështetur përmirësimet operative.

**Rreziku** Aranzhimet e dobëta të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

---

**Rekomandimi 3** Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë se është rishikuar plotësisht i pyetësorit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit si dhe për të siguruar adresimin e çështjeve të identifikuara. Kryetari i Komisionit po ashtu duhet të sigurojë që është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut dhe të sigurojë raportim dhe monitorim sistematik për zbatimin e kërkesave të këtij procesi.

## 2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit AKK operon dhe sfidat me të cilat përballet.

## 2.4 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

---

### Çështja 4 - Dobësi në kontrollet menaxheriale - Prioriteti i lartë

**E gjetura** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të AKK-së ka nxjerrë në pah një raportim të dobët financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat. Raportimi i brendshëm është i vendosur ndërsa dobësitë lidhen me mos mbajtjen e takimeve të rregullta me zyrtarët përgjegjës dhe se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth ndryshimeve në realizimin e buxhetit.

**Rreziku** Mos mbajtja e takimeve të rregullta dhe cilësia e dobët e raportimit financiar rezulton në reduktimin e aftësisë së menaxhmentit për të reaguar me kohë ndaj sfidave financiare dhe operative, si dhe në mos përmbushjen e objektivave të organizatës me kohë.

**Rekomandimi 4** Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri më 1 tetor 2016.

## 2.5 Sistemi i auditimit të brendshëm

AKK nuk i plotëson kriteret për të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB) bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 23/2009, për themelimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm në sektorin publik.

Në mungese të NjAB-së, Departamenti i Auditimit të Brendshëm në kuadër të MF-së për çdo vit kishte kryer nga një auditim të brendshëm në AKK. Megjithëse, për vitin 2016 nuk ishte kryer ndonjë auditim.

### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

#### Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

AKK ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit. Megjithatë, menaxhimi i pasurisë vazhdon të mbesë sfidë e vazhdueshme për AKK-në.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për AKK-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>224,810</b>	<b>181,178</b>	<b>179,476</b>	<b>125,979</b>	<b>147,477</b>
Granti i Qeverisë – Buxheti	224,810	181,178	179,476	125,979	147,477

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 43,632€ si rezultat i vendimeve të Qeverisë.

Në vitin 2016, AKK ka përdorur 99% të buxhetit final ose 179,476€, me një rritje prej 5% krahasuar me vitin 2015. Më poshtë janë dhënë shpjegimet për pozitën aktuale.

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>224,810</b>	<b>181,178</b>	<b>179,476</b>	<b>125,979</b>	<b>147,477</b>
Pagat dhe Mëditjet	160,104	142,104	140,429	97,902	100,587
Mallrat dhe Shërbimet	59,861	38,623	38,596	26,378	44,897
Shërbimet komunale	4,845	451	451	1,700	1,992

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar është zvogëluar për 18,000€ me vendim të Qeverisë;
- Po ashtu buxheti final për mallra dhe shërbime ishte zvogëluar për 21,238€ me vendim të Qeverisë; dhe
- Në lokacionin ku tashme operon AKK është e liruar nga një pjesë e shpenzimeve komunale, andaj si rezultat i suficitit të mbetur, ishte zvogëluar buxheti final për 4,394€.

### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

#### **3.1.1 Të hyrat**

Të hyrat e realizuara nga AKK në 2016 ishin në vlerë prej 3,000€. Burimi i këtyre të hyrave është nga realizimi i përqendrimeve të lejuara. AKK ka vendosur kontrolle funksionale në menaxhimin e të hyrave.

### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Buxheti për paga dhe mëditje ishte 142,104€, ndërsa ishin shpenzuar 140,429€ apo 99% të buxhetit. Testimi ynë në këtë kategori ka nxjerr në pah dobësinë në çështjen e paraqitur në vijim.

#### Çështja 5 - Shtesë e parregullt për stafin mbështetës - Prioritet i mesëm

<b>E gjetura</b>	Auditimi ynë i pagave ka identifikuar që një i punësuar pozita e të cilit është themeluar me Ligjin e Punës ka përfituar shtesën e shërbyesit civil në vlerë 30€ për muaj. Kjo ka ardhur si rezultat i mosfunksionimit efektiv të kontrolleve për të siguruar pajtueshmërinë me ligjet në fuqi.
<b>Rreziku</b>	Pagesa e shtesave pa bazë ligjore rezulton në papajtueshmëri me legjislacionin dhe reflekton pagesa të parregullta për AKK-në.
<b>Rekomandimi 5</b>	Kryetari i Komisionit duhet t'i forcojë kontrollet për të siguruar pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret për kompensimin e punonjësve. Kompensimi i të gjithë punonjësve që kanë themeluar kontratë me Ligjin e punës duhet të jetë subjekt i këtij ligji dhe ndryshimet e nevojshme duhet të reflektohen me kohë në listën e pagave.

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 38,623€. Prej tyre ishin shpenzuar 38,596€. Ato kryesisht kanë të bëjnë me shpenzimet e reprezentacionit, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare dhe shpenzimet tjera administrative.

AKK ka vendosur një sistem të kontrollit lidhur me mallra dhe shërbime që ka siguruar pajtueshmëri me legjislacionin për pagesat e bëra për kategori. Auditimi ynë ka identifikuar disa gabime jo materiale që janë konsideruar me prioritet të ulët të cilat janë raportuar përmes letër menaxhmentit.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.



## 3.2 Pasuritë

### 3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Objektivat në lidhje me trajtimin e pasurisë kanë të bëjnë me sigurimin dhe menaxhimin efektiv të pasurisë, si dhe mbajtjen e saktë dhe të plotë të regjistrave të pasurisë, përmes përditësimit të vazhdueshëm të të dhënave.

Vlera e pasurisë kapitale (mbi 1,000€) e AKK-së për vitin 2016 ishte 5,229€, ndërsa vlera e pasurisë jokapitale (nën 1,000€) ishte 3,915€. Testet tona shpalosen mangësinë si në vijim.

#### Çështja 6 - Mos inventarizimi i pasurisë - Prioritet i mesëm

<b>E gjetura</b>	Auditimi ynë ka identifikuar që AKK nuk e kishte përmbushur obligimin e saj për inventarizim e pasurisë në fund të vitit. Kjo kishte ndodhur për shkak të ndërrimit të lokacionit të AKK-së.
<b>Rreziku</b>	Mos inventarizimi, përveç që është në kundërshtim me Rregulloren për menaxhimin e pasurive, mund të rezultojë në dëmtim dhe/apo humbje të pasurisë. Për më tepër, kjo mund të shpie edhe në vlera të pasakta të pasurive në PFV.
<b>Rekomandimi 6</b>	Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë menaxhimin e pasurisë në përputhje me kërkesat e Rregullores për menaxhimin e pasurisë. Rëndësi e theksuar duhet t'i kushtohet procesit të inventarizimit në fund të vitit për të siguruar që e tërë pasuria është në gjendje të mirë dhe në shfrytëzim për qëllimin e përcaktuar.

## 3.3 Obligimet e papaguara

AKK në vitin 2016 nuk kishte paraqitur obligime të papaguara në PVF dhe se çdo pagesë e kishte kryer deri në fund të vitit 2016.

Raportimi i obligimeve ishte bërë në përputhje me Rregullën Financiare nr. 02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

---

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Sekretari i AKK-së duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implemtimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Është në proces të zbatimit, ende nuk është zbatuar plotësisht asnjë rekomandim.	
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Sekretari i AKK-së duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë proaktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		Në proces të zbatimit, pasi që në formularin e vet-vlerësimit ende nuk pasqyrohet gjendja faktike e AKK-së.	
2.5.1 Menaxhimi i rrezikut	Sekretari i AKK-së duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.			Nuk është zbatuar.

2.5.2 Raportimi menaxherial	Sekretari i AKK-së duhet të shqyrtojë aranzhimet ekzistuese të raportimit për të siguruar që mangësitë të identifikohen, dokumentohen dhe raportohen me kohë me qëllim të evitimit të tyre.		Është në proces të zbatimit, pasi që takimet e mbajtura në nivel menaxherial kanë raportime dhe procesverbale, mirëpo në nivel të departamenteve ende nuk kishte procesverbale të dokumentuara dhe raporte përveç raportit buxhetit.	
2.6 Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Sekretari i AKK-së të siguroj implementimin e rekomandimit të auditimit të brendshëm për inventarizim të pasurisë jofinanciare. Ndërsa sa i përket rekomandimit tjetër për formimin e Komisionit, ti drejtohet organit vendimmarrës me kërkesë për emërimin sa më të shpejtë të anëtarëve të Komisionit duke i sjellë në vëmendjen e tyre pasojat nga mungesa e bordit.		Është në proces të zbatimit po ende nuk është zbatuar plotësisht.	
3.6.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Sekretari i AKK-së të siguroj implementimin e rekomandimit të auditimit të brendshëm për inventarizim të pasurisë jo-financiare.			Nuk është zbatuar.

## Shtojca IV: Letërkonfirmimi

  
**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**Autoriteti Kosovar i Konkurrencës**  
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

---

**LETËR E KONFIRMIMIT**

**Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm  
për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve**

**Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Avdyl Krasniqi .....  
Sekretar i AKK-së

Data: 14.06.2017.

